



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 28.3.2022

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 28.3.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 342, datë 2.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elbana Lluri

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 30.3.2021, është njoftuar vendimi nr. 342, datë 2.2.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elbana Lluri, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 342, datë 2.2.2021, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c¹” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2² e ligjit nr. 84/2016, një komision prej tre vëzhguesish të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin nr. 205/1 prot., datë 31.3.2021: “Rekomandim për paraqitje ankimi”.

Komisioneri Publik, pas verifikimit të situatës faktike, analizës dhe vlerësimit të provave dhe akteve të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, në zbatim edhe të Rekomandimit të

¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së [...].

ONM- së, çmon se procesi i hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, përfundimet e arritura për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara, referuar kërkesave të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, e paraqet vendimin konkret për t'iu nënshtruar juridiksionit rivlerësues dhe kontrollues nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim referuar Kolegji), e për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kërkohet hetimi si më poshtë.

I. Vlerësimi mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit

1. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi dy pasuri të paluajtshme: (1) pasuri e paluajtshme e llojit “Apartament me sip.125 m²”, ndodhur në rrugën “****. ****”, Tiranë, pjesa takuese 50%; (2) pasuri e paluajtshme e llojit “Apartament me sip.126,5 m²”, ndodhur në Vlorë, pjesa takuese 50% dhe (3) një pasuri të luajtshme Automjet tip “Toyota”, me targa: ****, blerë në vitin 2016, për vlerën 5.000 euro, pjesa takuese 50%.

1.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit ka rezultuar se, për shkak të marrëdhënies së posaçme me personin e lidhur, ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, janë deklaruar edhe *të drejta përdorimi, së bashku me subjektin e rivlerësimit, mbi automjetin e babait të tij, z. ****.****, tip AUDI, me targa: ****.*

1.2 Në analizë të elementeve të lidhura me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, hetimit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, në zbatim të përmbajtjes së Rekomandimit të ONM-së, kërkohet hetim i mëtejshëm për sa u përket pasurive (1), (2) dhe (3), si dhe eventualisht automjetit tip Audi, të deklaruar si në përdorim, lidhur me çështjet në vijim:

- (i) Llogaritja e zërave përkatës financiarë, të deklaruar për krijimin e secilës pasuri, për të verifikuar dhe vlerësuar mundësitë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme nga të ardhura të ligjshme, pasuritë e deklaruara në Deklaratën “Vetting”, si dhe ato të rezultuara gjatë hetimit administrativ;
- (ii) Verifikimi i mundësisë financiare së personave të tjerë të lidhur (prindërit e subjektit të rivlerësimit), për të dhënë hua shumë 25.000 euro subjektit, në vitin 2011, duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit;
- (iii) Verifikimi i të drejtave të subjektit të rivlerësimit mbi automjetin tip Audi Q7, në pronësi të babait të personit të lidhur, referuar rrethanave faktike dhe juridike, si element përcaktues për nevojën e përlllogaritjes së mundësisë financiare në fitimin e pronësisë.

2. ***Pasuria nr. 1, “Apartament me sip. 125m²”, ndodhur në rrugën “****.****”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 125 m² Tiranë”)***

2.1 *Në D-Vett.* deklarohet: *Apartament banimi me sip. 125 m², me nr. pasurie ****, ZK ****, vol. ****, f. ****, kt. **, ap. **, ndodhur në rrugën “****.****”, Tiranë. Vlera: 6.500.000 lekë. Çmimi i blerjes është më i ulët se çmimi i tregut, për shkak të marrëdhënies së posaçme mes subjektit të*

rivlerësimit dhe znj. ***.*** dhe z. ***.*** *Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me z. ***.***³. Pjesa takuese prej 50% e subjektit të rivlerësimit është përfituar me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse. *Burimi i krijimit: (i) 5.000.000 lekë, kredi e marrë nga z. ***.***, pranë Bankës *** ***, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007; (ii) diferenca prej 1.500.000 lekë është siguruar nga kursimet personale ndër vite të bashkëshortit.**

2.2 *Në DV-2011*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar duke detajuar se: [...] *pjesa ime prej 50% është përfituar me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse. Dhurimi do të pasqyrohet në kontratën përfundimtare të shitjes, e cila do të hartohet në një datë të mëvonshme [...].*

2.3 *Në DV-2012*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Blerje apartamenti me të dhënat si më sipër, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., *** kol., datë **.10.2012, me vlerë 6.500.000 lekë, në bashkëpronësi me z. ***.***. Gjithashtu deklaroi se pjesa prej 50 % është përfituar prej saj me dhurim për shkak të marrëdhënies së posaçme me palën shitëse. Për pasojë, vlera e apartamentit është më e ulët se çmimi i tregut [...].*

2.4 Nga aktet në dosje rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.2.2011, dhe kontrata e shitjes nr. *** rep., *** kol., datë **.10.2012⁴.

2.5 Në nenin 3 të kontratës premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.2.2011, përcaktohet se vlera e objektit (6.500.000 lekë) është më e ulët se çmimi i tregut për shkak të marrëdhënieve të ngushta gjinore midis palëve kontraktore. Ndërsa në nenin 4, lidhur me modalitetet e pagesës, përcaktohet se pagesa do të bëhet me 2 këste: kësti i parë në shumën 1.500.000 lekë është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate; kësti i dytë prej 5.000.000 lekë do të kalojë në favor të palës shitëse, në momentin e lëvrimin të kredisë nga ***-ja te blerësi ***.***.

2.6 *Lidhur me burimin e pagesës së këstit të parë në shumën 1.500.000 lekë:*

2.6.1 Nga analiza financiare e kryer mbi mundësinë e personit të lidhur, z. ***.***, për krijimin e kursimeve në *cash*, për periudhën 2005⁵-2010, Komisionit i ka rezultuar se ky i fundit mbulon me burime të ligjshme kursimet e deklaruara në shumën 1.500.000 lekë për vitet 2005-2010, me burim të ardhurat nga paga si gjyqtar, me përjashtim të vitit 2010, ku ka rezultuar me balancë negative në shumën - 68.253 lekë.

2.7 *Mbi burimin e pagesës së këstit të dytë në shumën 5.000.000 lekë:*

2.7.1 Nga aktet e administruara ka rezultuar se kësti i dytë, në shumën 5.000.000 lekë, është paguar nëpërmjet kredisë së disbursuar z. ***.***, nga ***, përfituar prej tij bazuar në

³ Rezulton se subjekti ka lidhur martesë ligjore me shtetasin ***.*** në datën **.7.2012 dhe e ka zgjidhur atë me vendimin nr. ***, datë **.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴ Znj. ***. dhe z. ***.*** janë në cilësinë e palës shitëse dhe ***.*** dhe E. Ll. në cilësinë e palës blerëse.

⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 18.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: "...shuma është siguruar tërësisht nga ish-bashkëshorti im dhe ka ardhur si rezultat i kursimeve të realizuara nga ana e tij në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga viti 2004 e në vazhdim", duke detajuar dhe kursimet *cash* ndër vite nga ish-bashkëshorti që nga viti 2005 e në vijim, të deklaruara në deklaratat e interesave private periodike/vjetore, të dorëzuara në ILDKPKI.

VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”.

2.8 Për këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime rikonstruksioni dhe mobilimi, në shumën 25.000 euro, me burim kredinë e marrë nga *** Bank. Në deklaratat periodike vjetore është deklaruar kjo kredimarrje si më poshtë:

2.8.1 *Në DV-2009*, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit deklaroi marrjen e një kredie bankare pranë *** Bank, datë **.4.2009, në shumën 25.000 euro, pa specifikuar se në cilësinë e dorëzanësit është z. ***.***. Ndërkohë, ky i fundit, në deklarinimin e tij pranë ILDKPKI-së, në vitin 2009, deklaroi këtë marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit.

2.8.2 *Në DV-2011*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar mbi mënyrën e shlyerjes së kësaj kredie, si vijon: “Më datë **.2.2011 kam shlyer plotësisht kredinë bankare marrë në **.4.2009, pranë *** Bank, me huan pa interes, marrë nga prindërit e mi, në shumën prej 25.000 euro”.

2.8.3 *Në D-Vett.*, subjekti ka deklaruar në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” si vijon: “hua pa interes dhe afat, shuma 25.000 euro, marrë në vitin 2011 prej meje nga prindërit e mi, shumë e cila shërbeu për shlyerjen e kredisë së marrë në dt. **.4.2009 pranë *** Bank, kredi e shlyer tërësisht në dt **.2.2011”, hua e cila rezultoi si detyrim i pashlyer ndaj prindërve.

2.8.4 Nga korrespondenca me *** Bank (ish-*** Bank), referuar shkresës nr. *** prot., datë **.5.2019, ka rezultuar se kjo kredi është shlyer tërësisht në datën **.2.2011, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 24.500 euro nga e motra e subjektit, shtetasja ***.***⁶.

2.9 *Mbi huan 25.000 euro, deklaruar nga subjekti të marrë nga prindërit:*

2.9.1 Komisionit i ka rezultuar se në deklarinimin para ILDKPKI-së, datë 6.2.2015, sipas aktit: “Sqarime mbi deklarinimin e pasurisë nga z. ***.*** dhe znj. E. Ll. ”, është deklaruar se: [...] Shuma prej 25.000 euro që i është dhuruar subjektit të rivlerësimit nga babai i saj, z. ***.***, është dhënë *cash* pa ndonjë akt të shkruar për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë. Kjo shumë është siguruar nga z. ***.*** dhe znj. ***.***, nga kursimet e tyre familjare dhe mbahej prej tyre në banesë në formë *cash* [...].

2.9.2 Komisioni, për të verifikuar nëse shuma 25.000 euro është përfituar si dhurim apo është marrë hua, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *deklarimi si dhurim para ILDKPKI-së është një gabim material, pasi shuma është dhënë në formën e huas.*

2.9.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *si burim për krijimin e shumës 25.000 euro dhënë hua, përveç të ardhurave nga pensionet respektive të prindërve që nga viti 1994, ka shërbyer dhe shuma prej 40.000 lekë në muaj, që motra ime, znj. ***.***. (***) i ka dhënë prindërve të mi prej vitit 1995 e në vijim, pa ndërprerje, me qëllim përmbushjen e nevojave për jetesë mesatare dhe përbalimin e çdo shpenzimi tjetër që këta shtetas*

⁶ I pyetur nga Komisioni mbi arsyen e derdhjes së shumës së sipërcituar nga znj. ***.***, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka deklaruar, ndër të tjera, se ky depozitim është kryer prej saj për lehtësi veprimi.

*mund të kenë pasur nga viti 1995 [...]. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, në cilësinë e provës, akte mbi përfitimin e pensioneve për të dy prindërit, si dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2018, nënshkruar prej tyre, në të cilën, ndër të tjera, deklarohet se: [...]shuma prej 40.000 lekësh/muaj na është dhënë nga vajza jonë ***. ***. (***), me qëllim përmbushjen e nevojave për jetesë mesatare dhe përballimin e çdo shpenzimi tjetër që kemi pasur të nevojshëm [...].*

2.9.4 Komisionit, nga analiza e mundësisë së prindërve⁷ të subjektit të rivlerësimit, për të krijuar shumën prej 25.000 euro, nga viti 1995 deri në datën **.2.2011⁸, i ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumën përkatëse subjektit të rivlerësimit.

2.9.5 Për sa më sipër, Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti i ka marrë hua prindërve, ndërkohë që vetë ka pasur në dispozicion kursime *cash* të deklaruara ndër vite, i ka kërkuar shpjegime subjektit mbi logjikën e këtij veprimi.

2.9.6 Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në përfundim, për pasurinë *Apartament me sip. 125 m², Tiranë*, Komisioni nuk ka konstatuar problematika që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

3. Pasuria nr. 2, Apartament banimi me sip. 126.5m², ndodhur në Vlorë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 126.5 m², Vlorë”)

3.1 Në D-Vett, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 126,5 m² (verandë+banesë)*, nr. pasuri ***, ZK ***, Vlorë, tërësisht i mobiluar. *Vlera e pasurisë: 55.452 euro*. Burimi i krijimit: *kursimet e mia dhe të bashkëshortit tim, të realizuara gjatë gjithë jetës sonë, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë⁹ për efekt të ligjit 84/2016*. Pjesa takuese: *50% në bashkëpronësi me bashkëshortin ***.***.*

3.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë si më sipër (të njëjtin deklaram ka bërë dhe bashkëshorti, z. ***.*** në DV- 2016)¹⁰.

3.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë **.2.2019, rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2016, lidhur para noterit publik ***.***, me palë shitëse ***. dhe ***.*** dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj¹¹. Shuma është depozituar në *cash*, në datën **.9.2016, nga shtetasi ***.***, në llogarinë e noteres, pranë Bankës ***.***.

3.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa më poshtë:

⁷ Për shkak të konfirmimit të marrëdhënies së huas si më sipër, Komisioni i ka kualifikuar shtetasit ***. dhe ***.*** “person tjetër të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, dhe bazuar në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion provues ligjor mbi burimin e krijimit të shumës së huas së marrë nga prindërit.

⁸ Referohuni f. 10-11 të rezultateve të hetimit administrativ.

⁹ Në DV-2004, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 5 milionë lekë. Në DV-2003, ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi në shumën 2.5 milionë lekë dhe në DV-2004 gjendje *cash* në shumën 1.5 milionë lekë.

¹⁰ Në të njëjtin deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se më datë 31.12.2016, ka gjendje *cash* të mbajtur në shtëpi, në shumën 500.000 lekë dhe llogari bankare te ***. Tiranë, ku u depozitua shuma e çmimit të shitjes së automjetit tip “Citroen C4”.

¹¹ Rezulton se shitësit e kanë fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2014, me shitës shoqëria “****” sh.p.k., me ortak të vetëm ***.***, djali i znj. *** dhe z. ***.***, për çmimin prej 7.627.950 lekë.

3.4.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të investojë në pasurinë *Apartament banimi* në datën **.9.2016, duke rezultuar me një diferencë negative në shumën - 110.537 lekë¹².

3.4.2 Në lidhje me kursimet *cash* ndër vite të bashkëshortëve, të deklaruara të përdorura si burim krijimi për këtë pasuri: (i) nuk provohet me dokumentacion ligjor provues përmbushja e kriterëve të nenit D të aneksit të Kushtetutës në kohën e përfitimit të tyre, për të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga motra e saj, për periudhën 1997 - 2004, si e punësuar në biznesin familjar¹³, si dhe ngelet e paqartë forma ligjore e përfitimit të tyre; (ii) nuk provohen me dokumentacion ligjor të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshorti i subjektit përpara fillimit të detyrës, të cilat duket se kanë shërbyer si burim krijimi i kursimeve që janë përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Duke qenë se shtesat në gjendje *cash* para martese, për vitet 2005 – 2011, nga personi i lidhur i subjektit, janë deklaruar se janë përdorur në blerjen e pasurisë në vitin 2011 (pasurisë nr. 1), subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të gjendjes *cash* të ish-bashkëshortit për pjesën tjetër të deklaruar si të akumuluar *përpara fillimit të detyrës, deklaruar në vitin 2003*; (iii) nuk duket se të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshorti, nga shitja e automjetit në vitin 2011, të kenë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, për sa ato nuk janë deklaruar gjendje *cash* në deklarimin e vitit 2011.

3.5 Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të paraqitura¹⁴, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *lidhur me të ardhurat e subjektit të përfituara nga e motra, në shumën 35.000 lekë/muaj, për periudhën 1997-2004, duke mbajtur në konsideratë: (i) deklaratet e subjektit në DV e vitit 2004; (ii) mundësinë financiare të dhuruesve për të krijuar të ardhurat e dhuruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; (iii) këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti përpara emërimit në detyrë, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë përfitimin dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave [...]*¹⁵.

3.6 Mbi ligjshmërinë e kursimeve të deklaruara në *cash* nga z. ***.***, në vitet 2003-2004, Komisioni, edhe pse ka arsyetuar se: [...] *pretendimi i subjektit se këto të ardhura nuk kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, nuk është i mbështetur në prova, për sa kohë vetë subjekti ka deklaruar në D-Vett. se burim krijimi për apartamentin në Vlorë kanë qenë kursimet e saj dhe të bashkëshortit, të realizuara gjatë gjithë jetës së tyre [...], përfundimisht ka konkluduar se: [...] pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve dhe shpjegimeve, detyrimin për të provuar ligjshmërinë e gjendjes *cash* të deklaruar nga z. ***.***, në vitet 2003-2004, e ka ky subjekt rivlerësimi, në gjykim nga një trup tjetër, në kuadër të një hetimi të pavarur dhe të paanshëm [...]*¹⁶.

¹² Komisionit, sipas rezultateve të hetimit, gjithashtu, i ka rezultuar se: “...nga analiza e deklaratave *cash* duket se ata nuk kanë pasur gjendje *cash* të akumuluar gjatë viteve, me diferencë prej - 165.223 lekësh, në kohën e blerjes së pasurisë në Vlorë”.

¹³ Referohuni f. 16-17, në materialin “Rezultatet e hetimit administrativ”.

¹⁴ Për punësimin e ish-bashkëshortit gjatë periudhës 1995-2000, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës disa deklarata noteriale të hartuara gjatë hetimit administrativ nga shtetas të ndryshëm. Konkretisht: deklaratë noteriale nr. *** datë **.7.2018, e shtetasit ***.***; deklaratë noteriale nr. *** datë **.6.2018, e shtetasit ***.***; deklaratë noteriale nr. ***, datë **.7.2018, e shtetasit ***.***; deklaratë noteriale nr. ***, datë **.9.2020, e shtetasit ***.***.

¹⁵ Referohuni prg. 23.4.2, f. 15 e vendimit të Komisionit.

¹⁶ Referohuni prg. 23.5.1 dhe 23.5.2, f. 15 e vendimit të Komisionit.

4. Pasuria nr. 3, Automjet tip “Citroen C4”, blerë në vitin 2012 dhe shitur në vitin 2016

4.1 Në *D-Vett*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Të ardhura neto të siguruara nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë: ***, te personi fizik ***, sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol, datë **.11.2016, redaktuar para noterit publik ***, Tiranë. Vlera: 10.500 euro (në bashkëpronësi me bashkëshortin, z. ***).

4.2 Në *DV-2012*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Marrje në përdorim dhe posedim i automjetit tip “Citroen C4”, me targë: ***, me anë të kontratës së qirasë financiare (*leasing*) lidhur me shoqërinë “***” sh.a., nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.8.2012, dhe shtojcës nr. **, qiraja nr. ***, vërtetuar nga notere ***, Tiranë. Kontrata përfundon më datë **.8.2017. Shuma prej 9.679,47 euro e paguar, është siguruar në mënyrë të barabartë, nga kursimet personale të miat dhe të bashkëshortit tim. Vlera e sendit është 16.500 euro. Pjesa takuese: 50%.

4.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë **.1.2019, konfirmohet pasuri e përfituar me kontratën e qirasë financiare me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.8.2012, me palë shitëse shoqëria “***” sh.a. dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, përkundrejt çmimit 16.500 euro. Pjesa prej 54.5% e çmimit është likuiduar nga pala blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër nëpërmjet qirasë financiare me këste mujore.

4.4 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën nga **.1.2012 deri në **.8.2012, i ka rezultuar se: [...] subjekti nuk ka pasur mundësi të investojë në pasurinë automjet tip “Citroen C4” në datën **.8.2012, duke rezultuar me një balancë negative në shumën -1.014.739 lekë [...].

4.5 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në analizë financiare të burimeve të blerjes së kësaj pasurie të konsiderohet edhe: (i) shuma prej 1.200.000 lekë, e ardhur nga shitja e automjetit të bashkëshortit në vitin 2011¹⁷, si dhe (ii) rishikimin e shpenzimeve të udhëtimeve, të mbuluar nga puna e bashkëshortit dhe udhëtimeve të përbashkëta me familjarët e saj, për të cilat ka deklaruar se janë mbuluar nga e motra e saj, znj. ***.¹⁸

4.6 Në përfundim, Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar se: (i) se shuma prej 1.200.000 lekësh nuk është deklaruar si kursime në *cash* nga ish-bashkëshorti në DV-2011 dhe, rrjedhimisht, pretendimi i subjektit nuk qëndron; (ii) lidhur me pretendimin e subjektit mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit nga ana e motrës së saj, Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerësoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për mbulimin e kostove të qëndrimit në udhëtimet e përbashkëta disaditore prej motrës duhet të pranohet dhe,

¹⁷ Subjekti ka deklaruar se “...ish-bashkëshorti ka shitur automjetin tip “Mercedes Benz”, me vlerë 1.200.000 lekë, në vitin 2011, i blerë prej tij në dt. ** nëntor të vitit 2005... Mosdeklarimi si shtesë e gjendjes cash për vitin 2011 nga ana e personit të lidhur, e shumë 1.200.000 lekë, është një pasaktësi në plotësimin e deklaratës periodike vjetore nga ana e tij, sepse ky shtetas është mjaftuar me faktin që të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit janë marrë cash prej tij...”.

¹⁸ Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. 800 rep., nr. *** kol., datë **.2.2020, nënshkruar nga znj. *** dhe z. ***, të cilët deklarojnë se kanë mbuluar të gjitha shpenzimet e udhëtimeve, për subjektin dhe familjen e saj, për periudhën 2004-2017.

për rrjedhojë, duhen zbritur këto kosto qëndrimesh për udhëtimet në analizën finale financiare për vitin 2012, në vlerën 260.562 lekë.

5. Pasuria nr. 4, Automjet tip “Toyota”, me targa: ***

5.1 *Në D - Vett*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Automjet tip “Toyota”, me targë: ***, blerë nga shuma e përfitur nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë: ***. Automjeti është në bashkëshpronësi me bashkëshortin tim, z. ***.***, blerë nga z. ***.***, sipas kontratës për shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.12.2016, redaktuar nga noteri publik ***.***, Tiranë. *Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50%.*

5.2 *Në DV-2016*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pakësim të ardhurash për blerje automjeti tip “Toyota”, me targë: ***, blerë nga shuma e përfitur nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë: ***. Automjeti është në bashkëpronësi me bashkëshortin, blerë nga z. ***.***, sipas kontratës për shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.12.2016. *Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50%.*

5.3 Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar: Shtim të ardhura neto në shumën 10.500 euro, të përfitura nga shitja e automjetit tip “Citroen C4”, me targë: ***, te personi fizik ***.***, sipas Kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.11.2016, redaktuar nga noteri publik ***.***, Tiranë. *Pjesa takuese: 50%.*

5.4 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit si më sipër për këtë pasuri, konfirmohet: (i) nga DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë **.1.2019, si dhe nga (ii) lëvizjet e llogarisë së ish-bashkëshortit të subjektit pranë ***-së¹⁹, ku rezulton se në datën **.11.2016, në llogarinë e z. ***.*** është transferuar shuma 10.489 euro, me përshkrimin: “*By order of R.S. Person Fizik paguar makina sipas shitjes*”, dhe në datën **.12.2016 nga llogaria e z. ***.*** janë transferuar 5.000 euro, me përshkrimin: “***, E. Ll. për ***. dhe ***.***, pagesë për blerje mjeti Toyota *** sipas kontratës noteriale”.

5.5 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...]...*subjekti nuk ka pasur mundësi të investojë në pasurinë automjet tip “Toyota RAV4” në datën 29.12.2016, duke rezultuar me një balancë negative në shumën – 663.011 lekë [...].*

5.6 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar rishikimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me kursin e këmbimit të përdorur për konvertimin e kursimeve *cash*, nga monedha lekë në monedhën euro, të përdorura për blerjen e pasurisë *Apartament në Vlorë* në të njëjtin vit, si dhe rishikimin e zërit: “*shpenzime udhëtimi*”, duke pretenduar se një pjesë e shpenzimeve është mbuluar nga e motra, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.2.2020.

5.7 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se: [...]...*deklarimi i subjektit për mbulimin e kostove të qëndrimit në udhëtimet e përbashkëta disaditore prej motrës duhet të pranohet dhe, për*

¹⁹ Shkresa nga *** me nr. *** prot., datë **.2.2019.

rrjedhojë, duhen zbritur këto kosto qëndrimesh për udhëtimet në analizën finale financiare për vitin 2016, në vlerën 207.639 lekë [...].

6. Çështje të tjera

6.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit standard të datës 16.10.2017, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *kam pasur në përdorim së bashku me bashkëshortin tim, z. ***.***, automjetin e babait të tij, z. ***.***, tip AUDI, me targa ***. Ky automjet është përdorur nga bashkëshorti im vetëm për udhëtimet jashtë vendit me makinë. Aktualisht me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.7.2018 ..., automjeti i sipërcituar është shitur nga babai i bashkëshortit ... dhe nuk është më në pronësi të tij [...], duke saktësuar më tej se: [...] referuar kontratës së huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., dt. **.7.2011, ish-vjehri im i ka dhënë të drejtën e përdorimit të këtij automjeti ish-bashkëshortit tim, z. ***.***, por në disa polica sigurimi figuron edhe emri im si e siguruar me kartonin jeshil. Në kushtet kur unë nuk kam qenë asnjëherë drejtuese e këtij automjeti, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, por në cilësinë e pasagjeres kam shoqëruar bashkëshortin tim, i cili ka drejtuar gjithmonë dhe ka pasur i vetëm të drejtën e përdorimit për këtë automjet, në bazë të kontratës së sipërcituar, kam bërë këtë deklaram në pyetësorin e dërguar nga ana juaj ..., për shkak se në momentin e plotësimit të këtij pyetësori, figuroja e martuar me këtë shtetas [...].*

6.2 Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë *Automjet*, nga babai i bashkëshortit.

6.3 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *mesa kam dijeni, Automjeti tip "Audi", me targë: ***, është blerë nga shtetasi z. ***.*** nga shitësi z. ***.***, qytetar i SHBA-së, në shumën USD 37.000... sipas kontratës së dt. **.4.2011. Detyrimet doganore, AUT, TVSH të paguara nga z. ***.*** janë në shumën ALL 932.091... Shuma për blerjen e këtij automjeti është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga z. ***.*** ndër vite [...], duke vënë në dispozicion të këtyre shpjegimeve edhe disa akte në cilësinë e provës.*

6.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Referuar nenit Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, kjo pasuri e luajtshme, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë Vetting, duhet t'i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, nga përdoruesi i këtij automjeti, z. ***.***, në procesin administrativ të kryer ndaj tij nga një tjetër trup gjykues. Ky konkluzion i trupit gjykues mbi detyrimin e parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafët 1 dhe 4, vlerësohet në referim edhe të rrethanave faktike të subjektit të rivlerësimit dhe faktit se huapërdorja e këtij mjeti është dakordësuar mes bashkëshortit të subjektit dhe babait të tij, para martesës së dy subjekteve të rivlerësimit, dhe faktit se subjekti i rivlerësimit kishte mjet tjetër në pronësi [...].*

II. Analiza e shkaqeve të ankimit

7. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të aktit: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, ndaj vendimit nr. 342/2021 të Komisionit, i nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish të ONM-së, vlerëson, që në funksion të shkaqeve të këtij ankimi, Kolegji, brenda juridiksionit të tij kontrollues dhe rivlerësues, të riçelë hetimin administrativ, me qëllim kryerjen e një llogaritje të zërave përkatës financiarë për krijimin e secilës pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, për elementet trajtuar si më poshtë:

8. **Për pasurinë nr. 1, Apartament me sip. 125 m², Tiranë**, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së²⁰, vlerëson se Kolegji duhet të rikryejë llogaritjen e zërave përkatës financiarë të deklaruar mbi vlerësimin e mundësive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me të ardhura nga burime të ligjshme, këtë pasuri, sikundër detajuar në vijim:

8.1 *Lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së këstit të parë, kursime personale ndër vite të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.500.000 lekë*

8.1.1 Referuar gjendjes së akteve, kërkohet rivlerësimi nga ana e Kolegjit i mundësive financiare të personit të lidhur për krijimin me burime të ligjshme të shumës prej 1.500.000 lekë dhe interpretimit të përdorur nga Komisioni mbi analizimin e kursimeve nga të ardhurat e personit tjetër të lidhur vetëm me burim nga paga si gjyqtar për vitet 2005-2010, nisur dhe nga fakti se në D-Vett. dhe DV-2011, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deklarojnë si burim për pasurinë nr.1, kursime personale “ndër vite” të z. ***.***, duke mos përcaktuar momentin e realizimit të tyre.

8.2 *Lidhur me shpenzimet e kryera për rikonstruksionin dhe mobilimin e kësaj pasurie, me burim kredinë në shumën 25.000 euro*

8.2.1 Siç është trajtuar dhe në ankim, nga aktet e përcjella Komisionit nga *** Bank (ish- *** Bank), me shkresën nr. *** prot., datë **.2.2019, ka rezultuar se z. ***.*** është në cilësinë e dorëzanësit për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 25.000 euro nga *** Bank, sipas kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2009²¹. Kjo marrëdhënie dorëzanie deklarohet vetëm në deklaratën periodike vjetore të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, administruar si provë prej Komisionit.

8.2.2 Në zbatim të Rekomandimit të ONM-së²², duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me të kanë qenë në posedim të këtij apartamenti kohë më parë nga *momenti i deklarimit* të

²⁰ Referohuni pikës 2, f. 2-4 të Rekomandimit të ONM-së.

²¹ Qëllimi i kredisë është financimi i subjektit të rivlerësimit për shumën 25.000 euro, me qëllim rikonstruksionin e apartamentit prej 125 m² në Tiranë, të cilin subjekti dhe z. ***.*** kishin planifikuar ta blinin nga znj. ***.*** (motra e subjektit). Sipas kontratës së hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2009, si garanci për sigurimin e kredisë, është lënë i njëjti apartament, i cili në momentin e marrjes së kredisë nga subjekti ka qenë në titull pronësie të ***.***.

²² Referohuni pikës II. f. 4 të Rekomandimit të ONM-së.

fitimit të pronësisë, rrethanë e cila do të duhet të mbahet në konsideratë nga ana e Kolegjit, në vlerësimin tërësor të çështjes.

8.3 *Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për të dhënë hua shumën 25.000 euro (deklaruar si burim për shlyerjen e kredisë më sipër pranë *** Bank)*

8.3.1 Për këtë shkak ankimi, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, kërkohet nga Kolegji hetimi i mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, prindërve të subjektit, për krijimin me burime të ligjshme të shumës së dhënë hua, në vlerën 25.000 euro, deri në datën **.2.2011, pasi:

- i. shuma prej 40.000 lekë në muaj, dhënë si ndihmë financiare nga znj. ***.***, që nga viti 1995, përfshirë nga Komisioni në analizën e burimeve të ligjshme të prindërve, rezulton të jetë deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ të Komisionit (në përgjigje të pyetësorit nr. 2);
- ii. sikurse deklarohet në pyetësorin nr. 2 nga subjekti i rivlerësimit, si edhe në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2018 të shtetasve, z. ***.*** dhe znj. ***.***, shuma 40.000 lekë në muaj është dhënë nga znj. ***.*** Prindërve: [...] *me qëllim përmbushjen e nevojave tona për jetesë mesatare dhe për çdo shpenzim tjetër që kemi pasur të nevojshëm [...]*.
- iii. Komisioni, në analizën financiare të kryer për burimet e ligjshme të prindërve të subjektit, duket se, përveç të ardhurave nga pensionet mujore, ka përfshirë edhe shumën prej 40.000 lekë/në muaj, pretenduar gjatë hetimit administrativ si ndihmë prindërve nga motra e saj, duke nisur që nga viti 1995, ndërkohë që nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se në deklaratën e parë të dorëzuar në ILDKPKI, datë 23.3.2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“të holla, cash të ruajtura në shtëpi, vlera 5.000.000 lekë, pjesa takuese 100%, burimi: nga kursimet e mia dhe të familjes, dhuratë nga motra”,* çka duket se gjithë të ardhurat e subjektit dhe prindërve të tij, deri në fund të vitit 2004, kanë shërbyer si burim krijimi të shumës së kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në shumën 5.000.000 lekë, nisur dhe nga niveli i ulët të ardhurave të siguruara nga pensionet mujore gjatë kësaj periudhe²³.

8.3.2 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, çmohet i nevojshëm verifikimi i mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur, prindërve të subjektit, për të dhënë hua shumën 25.000 euro në vitin 2011, duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruara dhe të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, nisur nga janari 2005.

9. Për pasurinë nr. 2, Apartament me sip. 126,5 m², Vlorë, në vlerësimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie, nga aktet e administruara, konstatohet se regjimi pasuror martesor i subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj i përket bashkësisë ligjore në pjesë ideale, në mungesë të ndonjë marrëveshje të veçantë, të lidhur dhe deklaruar rregullisht.

²³ Në të njëjtën deklaratë, krahas të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës, puna në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe Universiteti “***”, subjekti ka deklaruar të ardhurat e prindërve të përbëra nga pensioni mujor, në shumat respektive.

9.1 Si burim për blerjen e kësaj pasurie, në D-Vett. është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit: *“kursimet e mia dhe të bashkëshortit tim, të realizuara gjatë gjithë jetës sonë, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat tona të pasurisë për efekt të ligjit nr. 84/2016”*, pa u specifikuar ndarja e tyre²⁴.

9.1.1 Për këtë shkak ankimi kërkohet nga Kolegji kryerja e një analize të re financiare, me qëllim verifikimin e zërave përkatës financiarë të deklaruar si të përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj për krijimin e kësaj pasurie.

9.1.2 Bazuar në sa më sipër, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së²⁵, si dhe bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit²⁶, kursimet *cash* të personit të lidhur janë elemente që do të duhet të analizohen në kuadër të ligjshmërisë të të ardhurave të përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie, për sa kohë që rezulton se kjo pasuri është blerë gjatë kohës së bashkëjetesës, deklaruar me burim nga kursimet e përbashkëta dhe është në bashkëpronësi dhe përdorim të subjektit të rivlerësimit.

9.2 *Mbi burimin e krijimit të kursimeve të personit të lidhur*, referuar gjendjes që janë aktet, nisur nga fakti që, sikundër trajtuar në burimet e pasurisë nr.1, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të pasurisë *“Apartament me sip. 125 m² Tiranë”* kursimet e viteve 2005-2011, kërkohet rivlerësimi nga Kolegji mbi mundësinë financiare të z. ***.*** për të provuar ligjshmërinë e burimeve të kursimeve *cash* të deklaruara si burim për blerjen e pasurisë *“Apartament banimi me sip.126,5 m², Vlorë”*²⁷, pasi deklaratat noteriale mbi marrëdhëniet e punësimit të tij për justifikimin e të ardhurave të ligjshme të realizuara përpara fillimit të detyrës si gjyqtar (*periudha 1995-2002*), duket se nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, sa kohë nuk provohet përmbushja e kriterëve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 të ligjit nr. 84/2016.

9.3 *Mbi burimin e krijimit të kursimeve të vetë subjektit të rivlerësimit*, deklaruar në shumën 5.000.000 lekë në vitin 2004, kërkohet rivlerësimi nga Kolegji mbi zërat:

9.3.1 *Të ardhurave në shumën 35.000 lekë/muaj* për periudhën 1997-2004, të deklaruara të përfituara prej subjektit i rivlerësimit nga e motra, në kushtet kur:

i) në D-Vett., subjekti i rivlerësimit deklaroi si një nga burimet e shumës së kursyer në vlerën 5.000.000 lekë, të ardhura nga punësimi te biznesi²⁸ i ndërtimit të motrës, znj. ***.*** (***.), me pagë 30.000 - 40.000 lekë në muaj;

ii) në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2018, të shtetasve ***. dhe ***.***, si dhe deklaratën nr. ***, datë **.6.2018, të shtetasve z. ***. dhe znj. ***.***, deklarohet se

²⁴ Bazuar në këtë deklaram, kursimet ndër vite të subjektit dhe personit të lidhur me të rezultojnë të përbëra nga: (i) shuma 5.000.000 lekë, gjendje *cash*, e deklaruar në deklaramin e parë të subjektit në vitin 2004; (ii) shuma 2.500.000 lekë, gjendje *cash*, deklaruar në deklaratën e parë nga personi i lidhur, në vitin 2003; si dhe (iii) kursimet e përbashkëta të subjektit dhe ish-bashkëshortit ndër vite.

²⁵ Referohuni pikës 2., f. 3-5 të Rekomandimit të ONM-së.

²⁶ Referohuni vendimit (JR) nr. 6/19, prg. 20.4 të KPA-së.

²⁷ Në DV-2003, personi i lidhur ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 2.500.000 lekë, ndërsa në DV-2004 ka deklaruar gjendje në *cash* në shumën 1.500.000 lekë.

²⁸ Në f. 7 të deklaratës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“...nuk kam pasur kontratë pune, pasi kam qenë e punësuar në një biznes familjar...”*.

subjekti i rivlerësimit ka qenë e punësuar pranë biznesit të ndërtimit dhe qiradhënies së motrës së saj, ***, ***, me pagë mujore 35.000 lekë;

iii) në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2020, shtetasit znj. ***. dhe ***.*** nuk referojnë marrëdhënie punësimi, por deklarohet se shuma prej 35.000 lekë në muaj i është dhënë subjektit të rivlerësimit [...] në formën e një shpërblimi simbolik, për ndihmën që ka ofruar në mbajtjen e fëmijëve të vegjël apo çdo nevojë tjetër familjare për të cilat ajo ofronte për të na ndihmuar [...], fakt ky i pretenduar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ.

9.3.2 Të kursimeve në cash të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore të viteve 2006-2007-2008, pasi nga verifikimi i akteve duket se Komisioni ka llogaritur si shuma të kursyera në cash për këto vite vetëm një nga zërat e deklaruar nga subjekti, në faqen 3 të deklaratave respektive, ku kërkohen të deklarohen ndryshimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme²⁹.

9.4 Rishikimi i zërave përkatës financiarë, si më sipër, do të ndikonte eventualisht në evidentimin e pamjaftueshmërisë financiare të viteve respektive, për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, investimet dhe kursimet në cash.

10. Diferencat negative për vitet 2012 dhe 2016, dhe çështje të tjera të konstatuara gjatë hetimit administrativ

10.1 Komisioneri Publik vlerëson se, në gjendjen që janë aktet, për sa u përket diferencave negative të viteve 2012 dhe 2016, përfundimi i arritur nga Komisioni në vendimin e arsyetuar mbi reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të (të llogaritura nga ana e Komisionit në vlerën totale prej rreth 2,6 milionë lekë për periudhën e rivlerësimit), bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, si dhe deklaratave noteriale të motrës dhe bashkëshortit të saj, të hartuara gjatë hetimit administrativ, mbetet i paqartë dhe jo i provuar, pasi mbulimi i këtyre shpenzimeve nuk rezultoi i deklaruar në deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të³⁰ apo përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të pyetësorit standard³¹.

10.1.1 Në të tilla rrethana, mbetet i nevojshëm rivlerësimi nga ana e Kolegjit i argumenteve të përdorura nga Komisioni lidhur me reduktimin e këtyre shpenzimeve, çka, eventualisht, do të ndikonte në mundësinë financiare të personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe investimet gjatë këtyre viteve.

10.2 Komisioneri Publik, për sa u përket konstatimeve të Komisionit mbi automjetin në përdorim nga familja e subjektit të rivlerësimit, në analizë të provave të administruara,

²⁹ Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në f. nr. 3 të deklaratës, ku kërkohet të deklarohen ndryshimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, konkretisht: të ardhura nga paga si gjyqtare, shumën 450.000 lekë; të ardhura si pedagoge nga Fakulteti “****”, në shumën 360.000 lekë, të ardhura nga shitja e automjetit, shumën 400.000 lekë dhe automjet tip “Opel”, në shumën 250.000 lekë, Komisioni ka llogaritur si shtesë kursime cash të vitit 2006 vetëm shumën 450.000 lekë.

³⁰ Sikundër rezultoi të kenë deklaruar përfitimin e shumës 500.000 lekë në DV-2015, me rastin e lindjes së djalit të tyre.

³¹ Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti ka ritheksuar se: “Dhurimet e kryera nga motra ime dhe bashkëshorti i saj përbëhen nga vlera monetare të përfituara nga viti 1997 deri në vitin 2004 dhe pjesa prej 1/2 në apartamentin e sipërcituar...”.

shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së³² për këtë çështje, konstaton se hetimi dhe konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk është i plotë, pasi personi i lidhur, dhe si rrjedhojë e marrëdhënies së posaçme me të, dhe subjekti i rivlerësimit nuk kanë deklaruar në D-Vett. përdorimin e automjetit tip “Audi Q. 7”, viti i prodhimit 2007, përkundrejt detyrimit ligjor përkatës, duke qenë se ish-bashkëshorti, z. ***,***, ka pasur të drejta përdorimi, sipas kontratës së huapërdorjes, lidhur në datën **.7.2011.

10.2.1 Pretendimet e subjektit mbi mungesën e detyrimit për deklarim të kësaj pasurie në përdorim, bazuar në: (i) kohën e fitimit të titullit të pronësisë së babait të ish-bashkëshortit mbi këtë automjet dhe (ii) momentit të lidhjes së kontratës së huapërdorjes mes këtyre dy të fundit (*përpara lidhjes së martesës ligjore mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur*), (iii) rrethanat e faktit të përdorimit të mjetit si pasagjere, eventualisht do të duhet të vlerësohen nga Kolegji në konsideratë edhe të rrethanave faktike të tilla si marrëdhëniet kontraktuale kredimarrëse, që kanë ekzistuar mes subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj përpara lidhjes së martesës ligjore.

III. Konkluzione

11. Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke disponuar çeljen e hetimit dhe marrjen e provave përkatëse, sipas kërtimeve të ankimit dhe kësaj parashtrëse.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

³² Referohuni pikës IV., f. 5-7 të Rekomandimit të ONM-së.